



**UNIVERSITETI I MITROVICËS**  
**UNIVERSITY OF MITROVICA**  
**"ISA BOLETINI"**

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës  
Tel: +381-28535725/535727

Kryesues i Senatit

Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 257/004

Dt 26.02.2018

Në bazë të nenit 48 pika 1.3 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", si dhe në bazë të kërkesës së Fakultetit të Edukimit, Senati i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 9.2.2018, mori:

**VENDIM**

- I. Aprovohet kërkesa e Fakultetit të Edukimit për lejimin e angazhimit të stafit akademik, për semestrin veror të vitit akademik 2017/2018, si në vijim:
  1. Një mësimdhënës për lëndët:
    - Praktika Pedagogjike II- 2 orë- Programi parashkollor-semestri IV.
    - Praktika pedagogjike IV- 1 orë- Programi parashkollor-semestri VIII.
    - Zhvillimi i kurrikulave- 2 orë- programi fillor-semestri VI
  2. Një mësimdhënës për lëndët:
    - Letërsi për fëmijë- 2+2 orë- Programi parashkollor-semestri II.
    - Letërsi për fëmijë- 3+2 orë- Programi fillor-semestri IV.
    - Metodologji e leximit letrar- 2+1 orë- Programi parashkollor-semestri VI.
- II. Angazhimi i mësimdhënësve për këto lëndë do të bëhet sipas përzgjedhjes së dekanatit, me kërkesë zyrtare të aprovuar nga prorektori për mësimdhënie, çështje të studentëve dhe kërkimeve shkencore.
- III. Angazhimi i mësimdhënësit nga pika I.2. do të bëhet për semestrin veror, por me marrëveshje deri në kthimin e mësimdhënësit të rregullt nga pushimi mjekësor.
- IV. Obligohet zyra e personelit për përgatitjen e kontratës për angazhim të stafit të propozuar nga Fakulteti i Edukimit dhe të aprovuar nga prorektori, sipas pikës I të këtij vendimi.
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Arsyetim**

Senati i Universitetit pasi shqyrtoi kërkesën e Fakultetit të Edukimit për lejimin e angazhimit të stafit akademik për lëndët e sipërpërmendura, e konsideroi të arsyeshme kërkesën, për arsye se mësimdhënësi i angazhuar për lëndët nga pika I.1., është tërhequr, ndërsa mësimdhënësi për lëndët nga pika I.2. është në pushim mjekësor pa afat. Marrë parasysh se mungesa e mësimdhënësve për këto lëndë do të pamundësonte vazhdimin e mësimin, Senati vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Fakultetit;
3. Drejtorit të DAP;
4. Zyrtarit për paga;
5. Zyrës së personelit;
6. Zyrtarit ligjor.



Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Kryesues i Senatit